

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Haga dënoi me 81 vjet burg ish-krerët e UÇK-së/ Cilat janë hapat që mund të ndiqen për apelimin e një vendimi të Speciales
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/haga-denoi-me-81-vjet-burg-ish-kreret-e-uk-se-kush-jane-hapat-qe-mund-te--i104497
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 16:34:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 16:23:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e0a0c03a1226ec944c9b86231294f0418de2a3036299703117965aae74738ad7
TEKSTI	4a4cc70b383033739baa114a006fbc0a081d2b56522ca64e443603636f5ee55
PAMJA	f810e7115205140603a085907d657aa151358e7916fd3fa8e7f00b4cdb5fd765

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4b91d5ccf787507d1831f82cfb0060ddfbf43541e9d516c07f64024084758f8b
E MËPARSHMJA	23c56fd4a035ef55cb70c07a6b3f7949cfe962fb783f1c9010ea4e7052723b4c
RRËNJA MERKLE	9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/4b91d5ccf787507d1831f82cfb0060ddfbf43541e9d516c07f64024084758f8b

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash: **Dyshohet se ka hequr** Eno Agasi është **pas dënimit të** për misionet të posaçme, Richard Grenell, reagoi **i norvegjezit** vazhdojnë të qarkullojnë, ndërsa **edhe Olta Xhaçkën: O** Ballën, protestuesit këtë herë **që dënoi me 81** gjykes në çështjen **vitet**

KOSOVA

Haga dënoi me 81 vjet burg ish-krerët e UÇK-së/ Cilat janë hapat që mund të ndiqen për apelimin e një vendimi të Speciales

Piranjat Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 18:23



Ekipet mbrojtëse të ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë paralajmëruar se do të apelojnë aktgjykimin dënues të shqiptuar nga trupi gjyqësor i Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë më 16 shtator.

Hashim Thaçi u dënua me 25 vjet burgim për katër pika të aktakuzës për krime lufte, Jakup Krasniqi po ashtu u dënua me 25 vjet burgim, ndërkaq Kadri Veseli me 18 dhe Rexhep Selimi me 13 vjet burgim.

Të katër ish-eporët e UÇK-së u shpallën penalisht përgjegjës për krime lufte që përfshijnë ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor, torturën dhe vrasjen e paligjshme. Gjatë aktgjykimit të shqiptuar në Hagë, trupi gjyqësor hodhi poshtë akuzat e ZPS-së për krime kundër njerëzimit.

Katërshtja e UÇK-së gjendet në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Vendimi i trupit gjyqësor mund të apelohej nga palët e përfshira, nga mbrojtja e cila mund të kërkojë rrezimin e aktgjykimit në tërësi apo të synojë uljen e dënimit për pika të caktuara të akuzës, por edhe Zyra e Prokurorit të Specializuar që mund të kërkojë ashpërsim të dënimit.

ZPS-ja mirëpriti vendimin dënues dhe shtoi se do të shqyrtojë të gjithë aktgjykimin, përfshirë edhe rrezimin e pikave të akuzës që kishin të bënin me krime kundër njerëzimit.

Por, cilat janë procedurat që palët ndjekin për apelim?

Sipas Rregullores së Procedurës dhe Provave, palët që apelojnë vendimin e gjykatës ose dënimit, ose të dyja së bashku, duhet të dorëzojnë atë që quhet njoftimin për apel, ku parashirohen arsyet e apelimit, 30 ditë nga shpallja e aktgjykimit.

Më pas, kryegjykatësi i panelit të Gjykatës së Apelit – gjykatë që përbëhet nga tre anëtarë – mund të caktojë një prej gjykatësve si gjykatës raportues për procedurën paraapeluese. Gjykatësi raportues ka për detyrë të marrë masat e nevojshme për aspektet procedurale, sikurse janë lëshimi i vendimeve, urdhrave dhe udhëzimeve me qëllim që të përgatitet çështja për shqyrtim. Ai duhet që rregullisht ta informojë panelin e Gjykatës së Apelit, veçmas nëse ka kontestime lidhur me çështjet procedurale.

Më pas, brenda 21 ditësh nga njoftimi për apel, kryegjykatësi apo gjykatësi raportues e thërret një konferencë ku ngrihen çështje rreth apelit.

Palët që parashirojnë apel duhet të dorëzojnë dosjen e apelit e cila përmban të gjitha argumentet dhe burime të tjera ligjore ku mbështeten arsyet e apelimit. Kjo duhet të dorëzohet brenda 60 ditësh apo brenda 30 ditësh nga njoftimi për apel, nëse çështja ka të bëjë vetëm me dënimin e shqiptuar.

Më pas palët dorëzojnë të ashtuquajturën dosje të përgjigjes, ku paraqesin argumentet ligjore të tyre. Afatet se kur dorëzohet kjo dallojnë: 30 ditë për argumentet dhe burimet ligjore dhe 15 ditë vetëm për dënimin nga paraqitja e dosjes. Kjo pasohet me dosjen e kundërpërgjigjes për të cilën afatet janë më të shkurtra, 15 dhe 10 nëse ka të bëjë vetëm me dënimin.

Pas gjithë këtyre afateve, Gjykata e Apelit e cakton datën e një seance “nëse është e nevojshme”, thuhet në rregulloren.

Rregullorja parasheh që palët mund të dorëzojnë prova shtesë gjatë procedurës së apelimit dhe nëse ato pranohen, pala tjetër mund të paraqesë kundërprova. Gjatë vendimit, Paneli i Apelit shqyrton çdo provë shtesë të pranuar, por edhe provat që veçse janë pjesë e dokumentacionit.

Sapo të përfundojnë parashtrimet nga palët, paneli i Apelit mbledhet dhe shqyrton çështjen dhe nxjerr aktgjykim për dokumentacionin e apelit dhe për çdo provë shtesë të pranuar.

Pra, Gjykata e Apelit mund të lërrë në fuqi, të zhbëjë ose të ndryshojë aktgjykimin e trupit gjyqësor apo të mbahet rigjykim.

Megjithatë, nëse kërkesa për apel bëhet vetëm nga personat e shpallur fajtorë, Gjykata e Apelit nuk mund të shqyrtojë vendim më të rëndë se shkalla e parë. Vendimi i apelit shqiptohet brenda 60 ditësh nga parashtrimi i fundit i palëve. Megjithatë, edhe për këtë mund të kërkohej kohë shtesë, por jo më shumë se një muaji dhe zgjatja e afatit duhet të arsyetohet.

Sipas Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar janë tri arsye për të cilat mund të dorëzohen apele për vendime të shkallës së parë: ndonjë gabim rreth ndonjë çështje juridike që e shfuqizon aktgjykimin, ndonjë gabimi faktik i cili ka shkaktuar dëshkrimin e drejtësisë ose ndonjë gabimi për sa i përket dhënies së dënimit.

Nëse palët nuk janë të kënaqura me vendimin e Apelit, çështja mund të dërgohet në Gjykatën Supreme dhe më pas në atë Kushtetuese të Dhomave të Specializuara në Hagë.

Mbrojtësit e ish-presidentit, Hashim Thaçi, thanë se procesi i apelit mund të marrë vite kohë. Pas 41 muajsh të nisjes së gjykimit, trupi gjykues gjeti fajtorë katër ish-eprorët e UÇK-së për krime lufte, por rrëzoi akuzat për krime kundër njerëzimit. Sipas trupit gjykues, katërshja e UÇK-së, së bashku me udhëheqës të tjerë, kishin për qëllim pavarësinë e Kosovës dhe vendosjen e kontrollit politik e institucional mbi një Kosovë të pavarur.

Sipas gjykatës, për realizimin e këtyre objektivave, ata kishin një qëndrim të përbashkët se disa persona që konsideroheshin pengesë për qëllimet e tyre duhej të "shënjestroheshin", "eliminoheshin" ose "neutralizoheshin".

Këta persona thuhet se përfshinin, ndër të tjera, anëtarë ose përfaqësues të forcave të tjera politike dhe ushtarake, veçanërisht persona të lidhur me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK), persona që konsideroheshin të lidhur me autoritetet serbe, si dhe pjesëtarë të komuniteteve romë dhe serbe.

Gjatë shpalljes së aktgjykimit, trupi gjykues tha se ky qëllim i përbashkët ishte zbatuar përmes vrasjeve, arrestimeve dhe ndalimeve pa proces të rregullt ligjor, si dhe keqtrajtimit fizik e psikologjik, frikësimit dhe përdorimit të asaj që në aktgjykim quhet "luftë speciale".

Trupi gjykues tha se ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli dhe ish-deputeti Rexhep Selimi, kontribuan në zbatimin e këtij qëllimi të përbashkët.

Në rastin e Thaçit, trupi gjykues tha se ai kishte luajtur rol kyç në formulimin dhe zbatimin e qëllimit të përbashkët, teksa konstatoi se kishte marrë pjesë edhe personalisht në disa prej krimeve, duke përmendur rastin e Behajdin Allaqit.

Për Veselin, Gjykata Speciale përmendi pozitën e tij si shef i Drejtorisë së Zbulimit të UÇK-së, organ që, sipas konstatimeve të trupit gjykues, kishte përgjegjësi për identifikimin, vëzhgimin dhe neutralizimin e personave të dyshuar si "kolaboracionistë". Dhomat e Specializuara thanë se ai nuk ndërmori hapa për parandalimin, hetimin ose ndëshkimin e krimeve, megjithëse kishte dijeni për to.

Për Selimin, trupi gjykues konstatoi se ai kishte kontribut të qenësishëm në zbatimin e qëllimit të përbashkët. Gjykata theksoi se pozita e tij si inspektor i Përgjithshëm i UÇK-së i jepte më pak pushtet mbi anëtarët e tjerë të UÇK-së, krahasuar me disa prej të akuzuarve të tjerë.

Ndërsa për Krasniqin, që në kohë të luftës kishte qenë zëdhënës i UÇK-së dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, gjykata konstatoi se ai kishte përdorur pozitën, rolin si udhëheqës, pushtetin dhe statusin e tij për zbatimin e aspekteve kriminale të qëllimit të përbashkët./rel/

Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 16 Shtator18:21

[Policia holandeze për protestat në Hagë: Dy të arrestuar dhe një polic i lënduar](#)

Dy protestues janë arrestuar dhe një zyrtar policor është lënduar lehtë gjatë protestës së mbajtur të mër...

KOSOVA 16 Shtator17:51

["Liria e Kosovës nuk ishte dhuratë. U pagua shtrenjtë"/ Nga Luiz Ejlli te Elvana Gjata, VIP-at shqiptarë reagojnë pas vendimit të Hagës](#)

Personazhet e njohur të ekranit kanë reaguar përmes postimeve në rrjetet sociale në lidhje me aktgjykimin që u dha sot ndaj kat&eu...

KOSOVA 16 Shtator17:41

[Vendimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë: Historia e Kosovës nuk rishkruhet](#)

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë ka reaguar pas vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj ish-krerëve të U...

KOSOVA 16 Shtator17:18

[Media shtetërore turke: Kosova dhe Shqipëria kritikojnë vendimin për Thaçin, ndërsa Franca mbështet gjykatën](#)

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dënohet me 25 vjet burg për krime lufte, përfshirë vrasje, torturë dhe ndalim arbit...

KOSOVA 16 Shtator17:00

[Richard Grenell kërkon mbylljen e Gjykatës Speciale pas dënimit të krerëve të UÇK: Kurti ta shpërbëjë! Vendimi skandaloz](#)

I dërguari i presidentit Donald Trump për misione të posaçme, Richard Grenell, reagoi ashpër pas vendimit të Gjykatës ...

KOSOVA 16 Shtator16:57

[Blero reagon pas vendimit në Hagë: Sot na dënuan të gjithëve, thjesht jam pa fjalë](#)

Këngëtar Blero ka reaguar pas shpalljes së aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Hagë, duke shprehur zhg&e...

KOSOVA 16 Shtator16:48

[Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së, Koçeku: Dënimi e glorifikon krimin në Ballkan](#)

Deputetja e pavarur tashmë Marjana Koçeku, ka reaguar pas vendimit të Gjykatës së Hagës për të dënuar me 81 vite ...

KOSOVA 16 Shtator16:46

["Dasma, lindje, humbje..." / Jeta e katër familjeve të komandantëve të UÇK, në mungesë të tyre](#)

Vendimi i Gjykatës së posaçme të Hagës për dënimin me burg për 4 ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Ko...

KOSOVA 16 Shtator16:27

[Vendimi i Hagës për liderët e UÇK-së, protestuesit hedhin gurë drejt godinës qeveritare në Prishtinë](#)

Disa qytetarë kanë hedhur gurë në drejtim të ndërtesës së Qeverisë së Kosovës në qendër të...

KOSOVA 16 Shtator16:21

[Dënimi në Hagë/ Thyhen xhamat e bazës së EULEX-it, bllokohet rruga Prishtinë-Fushë Kosovë](#)

Vendimi i Hagës, i cili la në burg krerët e UÇK-së ka zemëruar popullin e Kosovës, të cilët kanë sulmuar b...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[Pagat ndryshojnë strukturë/ Gati gjysma e të pu...](#)

Një e katërta e të punësuarve që derdhin kontributin e parë me pagë deri në 50 mijë lekë në muaj, nd&eu...

KOSOVA 16 Shtator

[Dënohet me 25 vite burg Hashim Thaçi](#)

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shpallur fajtor për krime lufte dhe është dënuar me 25 vjet burgim nga...

KOSOVA 16 Shtator

[Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...](#)


Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimagjias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...


video



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV





Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.